



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Dërgimin në gjyq të çështjes nr. 31 të vitit 2024, me të pandehur **Besim Çepele**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 245/1, pg.4 i Kodit Penal.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Ardit Mustafaj, Erjon Çela dhe Flojera Davidhi, me vendimin Nr. 54, datë 02.10.2024 vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Besim Çepele**, për veprën penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 4 K.Penal, dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.
2. Në bazë të nenit 406, pika 1, të K.Pr.Penale, të pandehurit **Besim Çepele**, i ulet 1/3 e dënimit dhe dënohet përfundimisht me **1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim**.
3. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia e të pandehurit në provë, për një afat prove prej **2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj**, gjatë së cilës i pandehuri duhet të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë vepër tjetër penale.
4. Bazuar në nenin 60, paragrafi i parë, pika 9 të K.Penal, urdhërohet i pandehuri që brenda periudhës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar për vepra penale.
5. Afati i provës fillon pas marrjes formë të prerë të vendimit, nga momenti i kontaktit të parë të të pandehurit me shërbimin e provës.
6. Bazuar në nenin 389 të K.Pr.Penale, deklarohet shuarja e masave të sigurimit “*Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, të caktuar ndaj të pandehurit Besim Çepele me vendimin nr. 64, datë 24.06.2024, të Gjykatës e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
7. Lidhur me provat materiale: Telefonat celulare Motorola dhe Samsung A10, që i janë sekuestruar shtetasit Ardjan Çepele, t’i kthehen atij.

8. Shpenzimet procedurale, të përbëra nga shpenzimet e hetimit paraprak dhe ato të gjykimit, sipas përlogaritjes nga sekretaria gjyqësore, i ngarkohen të pandehurit.
9. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Tiranë, më datë 02.10.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar